



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 1 e datës 12 .01.2012, Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

I. Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e banesore, në këtë përbërje: (në vazhdim të tekstit Komisioni)

1. Hasim Vishesella, Kryetar i Komisionit
2. Lumnije Ejupi , anëtare e Komisionit
3. Ramadan Hoxha, anëtar i Komisionit
4. Shahadije Ibrahim, anëtare e Komisionit

II. Komisioni, për zbatimin e dispozitave të Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 12 .01.2012 dhe dispozitave të Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 , autorizohet si vijon :

1. Kompletion shënimeve të kërkuara me Ligjin e cekur për banesat në pronësi të Komunës të cilat ende nuk janë blerë nga bartësit e të drejtës banesore.

2.Njofton bartësit e së drejtës banesore, përkatësisht shfrytëzuesit e banesës për të drejtën për blerjen e banesës dhe dokumentacionin i cili duhet t'i bashkëngjitet kërkesës në pajtim me Ligjin.

3.Shqyrton kërkesat e bartësve të së drejtës banesore për banesat të cilat dhënësi i banesave është Komuna si dhe për banesat për të cilat do të vërtetohet paraprakisht se nuk iu dihet kush do të jetë shitësi konform dispozitave të nenit 10 të Ligjit bazik.

4.Në pajtim me Ligjin, me dëshmi përkatëse vërteton se a është parashtruesi i kërkesës në grupin e personave që e kanë të drejtën për blerjen e banesës.

5.Në rast të kërkesave të paprecizuara dhe të dokumentacionit të pakompletuar s kërkon nga parashtruesi i kërkesës precizimin e kërkesës dhe kompletimin e dokumentacionit.

6.Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nxjerr Vendimin përkatës dhe lidhur me kërkesat e aprovuara përgatit për nënshkrim Kontratën e shitblerjes në pajtim me Ligjin.

7. Gjatë gjithë punës së tij, Komisioni është i obliguar t'i përmbahet procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe Ligjit nr.04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 28 prill 2014 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit Nr.04/L-247, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 22 mars 2022 .

III. Punët administrative – teknike për Komisionin i kryen Sektori pronëso-ro-juridik, ndërsa për kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet e blerjes, Komisionit në kalkulimin e çmimit të shitjes do t'i ndihmojë Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

IV. Me Vendim të njoftohen Kryetari dhe anëtarët e Komisionit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori Pronëso-ro- Juridik .

1Nr. 020/04-21636
Lipjan, më 28.06.2022

